

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS

UDHEZIME PER REGJISTRIMET

Hyrje:

Kur një fëmijë aplikon për pranim në ndonjë shkollë, bëhet përgjegjësi e shkollës plotësimi i procesit të regjistrimit, nëq ai/ajo janë në zonën që përfshin shkolla, ose duhet që menjëherë të japë informacionin e plotë, për fëmijën se ku duhet të aplikojë.

Nxënësit që përfshihen në kufirin e zonës së shkollës kanë të drejtën ligjore të vazhdojnë shkollën deri në moshën 21 vjeç, përveçse në rastet kur janë diplomuar në një shkollë, ose janë të përjashtuar. Në raste të tilla, nxënësit që dëshirojnë të kthehen në shkollë, duhet të marrin leje që të regjistrohen, ose të reregjistrohen në klasa të regullta ditën.

Procedurat:

Duke hyrë në fuqi menjëherë, këto procedura i shfuqizojnë të gjitha procedurat dhe praktikat e mëparëshme për procesin e regjistrimit të nxënësve në shkollat dhe programet e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias.

Një fëmijë duhet të lejohet të ndjekë shkollën, ditën tjetër të shkollës, pas ditës së paraqitjes për regjistrim dhe në të gjitha rastet brenda pesë (5) ditëve pune të marrjes së dokumentacionit të kërkuar nga drejtoria arsimore. 22 Pa. Code §11.11(b).

Informacioni i kërkuar:

Si pjesë e përpjekjeve të Drejtorisë për mbajtjen e mjediseve të sigurta për nxënësit, shkolla mund të kërkojë si vijon:

- Një kopje të kartës së identifikimit me fotografi të prindit/kujdestarit, në çastin e regjistrimit. Kopja do të ruhet me qëllim verifikimin e personave që do të shoqërojnë fëmijën në ardhjen dhe largimin nga shkolla..
- Në vazhdim, shkolla mund të kërkojë rekordet mjeksore ose fizike, rekordet mësimore, të frekuentimit, Programeve të Edukimit të Individualizuar dhe rekorde të tjera të edukimit special, në mënyrë që nxënësi të caktohet në klasën/nivelin e duhur me mbështetjen e nevojshme.

Ju lutemi bëhuni me dije: Megjithëse shkollat mund të kërkojnë informacione për këto, kjo nuk mund të jetë konditë për regjistrimin, ose pranimin dhe nuk mund të shërbejë si shkas në vonimin e regjistrimit të fëmijës, ose të frekuentimit, deri sa këto dokumente të paraqiten. Shkolla do t'i ndjekë këto kërkesa me prindin/kujdestarin, pasi fëmija të jetë regjistruar në shkollë.

Dokumentat e Kërkuara

1) *Provë e moshës së fëmijës (kërkohet njëra si më poshtë)*

Dokumentat e pranuar përfshijnë (në vijim janë shembuj dhe jo lista përfundimtare):

- Çertifikata origjinale e lindjes
- Kopje e noterizuar e çertifikatës së lindjes
- Pasaportë e vlefshme e fëmijës
- Çertifikata origjinale e pagëzimit, që tregon datëlindjen e fëmijës
- Kopje të pagëzimit- e noterizuar, ose e vërtetuar regullisht dhe që tregon datëlindjen
- Deklaratë e noterizuar nga prindërit ose të afërm të tjerë, e cila tregon datën e lindjes
- Rekorde nga shkolla e mëparëshme, ku tregohet data e lindjes

2) *Rekorde të Vaksinimeve (kërkohet njëra si më poshtë)*

Dokumentat e pranuar përfshijnë:

- Rekordet e vaksinimit të fëmijës
- Një deklaratë me shkrim nga drejtoria arsimore e mëparëshme, ose nga një zyrë mjekësore, ku shprehet se vaksinimet e kërkuara, janë kryer, ose ato janë në vazhdim,
- Sigurim verbal nga drejtoria e mëparëshme arsimore, ose nga një zyrë mjekësore, ku shprehet se vaksinimet e kërkuara, janë kryer dhe dokumentacioni është në procesin e dërgimit.

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS

UDHEZIME PER REGJISTRIMET

Përrjashtimet nga Vaksinitet

(a) *Përrjashtimi Mjekësor.* Fëmija mund të mos vaksinohet, në rast se një mjek, ose një person i caktuar prej tij, ofron një deklaratë me shkrim, që vaksinitimi mund të jetë i dëmshëm për shëndetin e fëmijës. Në rastin kur një mjek nuk e vlerëson më vaksinitimin të dëmshëm për shëndetin e fëmijës, fëmija do të vaksinohet në përputhje me këto rregulla.

(b) *Përrjashtimi për shkaqe të besimit fetar.* Fëmija mund të mos vaksinohet, në rast se prindi, kujdestari ose dhe vetë fëmija e kundërshton vaksinitimin bazuar në baza fetare, ose në bindje mbi baza morale e etike të krahasueshme me besimin fetar.

Ju lutemi bëhuni me dije: Në rastin kur nxënësi i ka filluar seritë e vaksinitimeve, ai mund të regjistrohet në shkollë. Nxënësi duhet të jetë në vazhdim të procesit dhe të jetë në afatet e kërkuara (p.sh nxënësi merr dozën e parë dhe ai/ajo merr dozën e dytë pas një muaji të dozës së parë). Ju lutemi [klikoni këtu](#) të shikoni Programin e Vaksinitimeve për Pranimit në Shkollë të Departamentit të Shëndetit e Kontrollit të Sëmundjeve të Filadelfias.

3) *Prova të Adresës (vetëm dy (2) si më poshtë kërkohen)*

Dokumentat e pranuar përrshijnë: *Shkollat duhet të jenë fleksibël në verifikimin e vendbanimit, dhe duhet të marrin në konsideratë informacionin që është i arsyeshëm në këndvështrimin e situatës familjare.*

- | | |
|---|--|
| 1. Dokumenti i Pronësisë së Shtëpisë | 10. ID e vlefshme nga Departamenti i Transportit (DOT) |
| 2. Faqja e deklaramit të Huamarrjes | 11. Fatura e fundit e kredit kartës |
| 3. Faturat e shërbimeve të fundit (gaz, elektrik, kabëll, telefon) | 12. Regjistrimi i fundit i makinës |
| 4. Fatura e fundit e taksës së pasurisë | 13. Karta e regjistrimit për votim, me adresën e fundit |
| 5. Patentë e vlefshme, ose karta për ndërrimin e adresës, me adresën tuaj të re | 14. Shkresa e fundit e bankës me adresën aktuale |
| 6. Letër nga zyra e "Social Security" me adresën aktuale | 15. Deklarim i IRS, ose deklarim i pagesës dhe i taksave, p.sh., W2, 1040, 1099 |
| 7. Letër nga zyra e "Public Assistance Office" me adresën aktuale | 16. Çeku i fundit i punës me adresën aktuale |
| 8. Letrat nga institucione si "Foster care/childcare dhe DHS" janë të pranueshme për regjistrim kur nxënësi është nën kujdesin e agjensive të kujdesit të fëmijës | 17. Letra të vendstrehimit, ose vendbanimit janë të vlefshme për nxënësit pa shtëpi |
| 9. Origjinali i qiramarrjes me emrat e prindit, kujdestarit dhe fëmijëve | 18. Kontrata e blerjes së shtëpisë, bashkë me kopjen e origjinalit të letrave të datës së blerjes saj jo më shumë se 45 ditë kalendarike |

4) *Deklarata e Prindit për Regjistrim (përrshihet në formularin e regjistrimit të Nxënësit EH40, që jepet nga shkolla)*

Një deklaratë nën betim, që vërteton nëse nxënësi ka qenë ose është i pezulluar, i përjashtuar për vepra që përrshijnë drogën, alkoholin, armët, shkaktimit të dhunës ose lëndimeve në territorin e shkollës, duhet të paraqitet për një nxënësi që të pranohet në komunitetin e shkollës 24 P.S. §13-1304-A. Shkolla nuk mund të vonojë ose mohojë regjistrimin e një fëmije në shkollë bazuar në informacionin që është në rekordet, ose në deklaratën e dhënë nën betim. Megjithatë, nëse nxënësi është përjashtuar për veprime me armë, shkolla mund të ofrojë për nxënësin shërbime mësimore alternative gjatë periudhës së përjashtimit. 24 P.S. § 13-1317.2(e.1) Në rast se rekordet disiplinore, ose dëshmia nën betim tregon se nxënësi është përjashtuar nga shkolla e mëparëshme, për shkaqe të tjera nga veprimet me armë, rekomandohet një rishikim nga ana e shkollës i performancës dhe rekordeve të mëparshme të nxënësit, për përcaktimin e shërbimeve dhe mbështetjeve të duhura, me regjistrimin në drejtorinë arsimore.

5) *Pyetësori për Gjuhën që flitet në Shtëpi (përrshihet në formularin e regjistrimit të Nxënësit EH40, që jepet nga shkolla)*

Të gjithë nxënësit që kërkojnë të regjistrohen për herë të parë në shkollë, do të plotësojnë pyetësin për gjuhën që flitet në shtëpinë e tyre, në përputhje me kërkesat e Zyrës për të Drejtat Civile të Departamentit të Arsimit të SH.B.A. Regjistrimi i nxënësit gjithsesi nuk mund të vonohet për shkak të pyetësorit.